


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT ADMINISTRATIV

Nr. 370 Prot

Tirane, me 03.09.2019

NJOFTIM LIDHUR ME ZBATIMIN E VENDIMIT NR.78 DT.30.05.2019 TE
KESHILLIT TE LARTE GJYQESOR

Per dijeni: Keshillit te Larte Gjyqesor.

Me date 11.06.2019, me eshte komunikuar Vendimi Nr.78 Dt.30.05.2019 i Keshillit te Larte Gjyqesor "Per kalendarin e shqyrtimit te ceshtjeve ne gjykatën e apelit".

Ne zbatim te vendimit te mesiperm, bej me dije se jane mbi 110 kerkesa per pershpejtim te paraqitura nga palet, te cilat presin te shqyrtohen.

Te gjitha keto kerkesa permbajne shkaqe te cilat diktojne gjykimin e ceshtjes me procedure te pershpejtuar.

Rrjedhimisht, asnje kerkesa per pershpejtim nuk eshte refuzuar, ne kuptim te Pikes 9 te Kreut III te Vendimit Nr.78 Dt.30.05.2019 te Keshillit te Larte Gjyqesor.

Nga verifikimet ne sistem, rezultoj gjyqtar me 1375 dosje qe presin te gjykohen prej meje, per shqyrtimin e te cilave zbatohet rendin kronologjik, me pike referimi daten e regjistrimit te tyre dhe mesatarisht planifikoj 30 ceshtje ne muaj.

Per te shqyrtuar te gjitha ceshtjet per te cilat ka kerkesa per pershpejtim do te duheshin rreth 4 muaj, qe do te thote se ceshtjet te cilat kane mbi 3 vite qe presin per gjykim do te mbeteshin pa gjykuar dhe per 4 muaj te tjere.

Rrjedhimisht, arsyet e voneses per gjykimin e ceshtjeve per te cilat ka kerkesa per pershpejtim, jane te njejta me 1375 ceshtjet e tjera, te lidhura me pamundesine objektive te perballimit te kesaj ngarkese brenda nje afati te arsyeshem.

Duke ritheksuar se asnje kerkesa per pershpejtim nuk eshte refuzuar, bej me dije se ceshtjet qe lidhen me to, do te behen pjese e ceshtjeve qe do te gjykohen sipas kronologjise (dates se regjistrimit), duke iu shtuar ketyre te fundit ne nje mase te perballueshme per gjykim.

Ky vendim tu komunikohet paleve qe kane paraqitur kerkesa per pershpejtim, si dhe te afishohet ne kendin e njoftimeve te Gjykeses se Apelit Administrativ dhe ne faqen elektronike te kesaj gjykate.

